



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 216, Datë 24.08.2022

MBI

**PEZULLIMIN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “LIRIA ENERGJI” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1476/2 prot., datë 19.08.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Liria Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 136, datë 06.06.2022, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “LIRIA ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për arsye të rritjes së kapacitetit të HEC-it “Shpella Poshtë 2”, nga 2300 kW në 4530 kW.
- ERE ka bërë njoftimin në median e shkruar për këtë vendimmarrje, i cili është botuar në datat 08.06.2022 dhe 09.06.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.07.2022) nuk ka rezultuar të kishte të tilla. Subjekti është njoftuar për vendimmarrjen e nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 136/2022 me shkresën nr. 778/1 prot., datë 09.06.2022 dhe shkresën nr. 778/2 prot., datë 28.07.2022, për vendimin e fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim dokumentacioni.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 778/3 prot., datë 10.08.2022, shoqëria “LIRIA ENERGJI” sh.p.k. ka dhënë shpjegime dhe ka përcjellë dokumentacion plotësues të aplikimit. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se nuk është përcjellë ende në ERE konfirmimi/qëndrimi i organeve kompetente në lidhje me këtë modifikim, përkatësisht i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vlefshmërinë e VNM-së Paraprake, i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) për vlefshmërinë e lejes së përdorimit të burimit ujor, i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) për miratimin e pikës së lidhjes me operatorin e rrjetit, si dhe i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM).

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: nëse *organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.*
- Për gjithë sa më sipër vlerësohet që të pezullohet vendimmarrja e bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “LIRIA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin e miratimit/ qëndrimit përkatës nga AKM, AMBU, OST sh.a. dhe KKDM, të cilave ERE do t’i drejtohet vetë me kërkesat respektive për informacion.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë vendimmarrjen e bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “LIRIA ENERGJI” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri kur të depozitohet në ERE miratimi/qëndrimi përkatës i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vlefshmërinë e VNM-së Paraprake, i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore për vlefshmërinë e lejes së përdorimit të burimit ujor, i Operatorit të Sistemit të Transmetimit për miratimin e pikës së lidhjes me operatorin e rrjetit, si dhe i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI